



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.27

28 mars

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.123, datë 17.2.2011

Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e
zhurmave në mjedis.....

963

VENDIM
Nr.123, datë 17.2.2011

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E
ZHURMAVE NË MJEDIS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 20 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E ZHURMAVE NË MJEDIS

LISTA E SHKURTIMEVE

MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPRR	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
INSTAT	Instituti i Statistikës
BE	Bashkimi Europian
PE	Parlamenti Europian
ANTA	Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror
TIA	Tirana International Aeroport
MDI	Mjete dite në inventar
MDP	Mjete dite në punë
MVDI	Mjete vend dite në inventar
MVDP	Mjete vend dite në punë

HYRJE

Shqipëria ka një eksperiencë në vlerësimin e ndikimit të zhurmave në mjedis kryesisht në ambientet e brendshme, ku Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj në qendër dhe në rrethe kanë bërë këtë vlerësim. Vlerësimet më të fundit i përkasin periudhës 2001-2008, nga të cilat rezulton se zhurmat në mjedis, veçanërisht në qendrat urbane kanë tendencë në rritje. Ky plan veprimi, duke marrë në konsideratë eksperiencën e deritanishme, ka për qëllim analizën, planifikimin dhe implementimin e masave të domosdoshme për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis për të shmangur efektet negative që ato kanë në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve. Burimet e zhurmave në mjedis mund të jenë të shumta, por në këtë plan veprimi do të analizohen zhurmat e shkaktuara nga transporti (rrugor, hekurudhor, ajror), aktivitetet e shërbimit social që gjenerojnë zhurma nëpërmjet muzikës (bare, restorante, pabe, disko), si dhe makineritë dhe pajisjet e ndryshme në ambientet e jashtme.

Rregullat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis përcaktohen në ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis dhe direktivave europiane”, që rregullojnë nivelet e lejuara të zhurmave nga burimet e mësipërme dhe konkretisht (Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council, of 25 June 2002, relating to the assessment and management of environmental noise), si dhe direktivave të tjera që përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë, si dhe zhurmat e gjeneruara nga sektori i shërbimeve publike (restorante, bare, disko etj.).

Ky plan veprimi analizon dhe parashikon masa ligjore, administrative dhe organizative të domosdoshme për t’u ndërmarrë me qëllim të përmbushjes së kërkesave të ligjit për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis, si dhe të kërkesave të direktivës bazë të BE-së, si dhe të direktivave të tjera të lidhura me këtë çështje me synimin e administrimit të qëndrueshëm dhe reduktimit të nivelit të zhurmave në mjedis. Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.

Në objektivat afatshkurtër të këtij plani veprimi synohen të përfshihen aktivitete dhe masa që kanë për qëllim përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor me direktivat e BE-së, ndërsa në planin afatgjatë parashikon objektiva dhe masa, që lidhen me ndërhyrjen në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, me qëllim të përmbushjes së standardeve të parashikuara për nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis.

Kërkesa minimale të përmbajtjes së planit të veprimit sipas direktivave të Bashkimit European

Hartimi i planit të veprimit për menaxhimin mjedisor të zhurmave është një detyrim i shteteve anëtare të BE-së, që në zbatim të direktivës nr.2002/49 EC, të hartojnë planet e menaxhimit për vendet e tyre dhe të përgatitjes së hartave të zhurmës. Pas përgatitjes së planeve kombëtare, direktiva parashikon dhe përcakton afate të hartimit të planeve lokale të zhurmave.

Direktiva parashikon dhe një sërë kërkesash bazë që duhet të përmbajë plani kombëtar i veprimit për një vend. Ato janë kërkesa që janë marrë për bazë edhe në këtë plan veprimi. Edhe pse nuk jemi shtet anëtar, Shqipëria ka filluar procesin e stabilizim-asociimit dhe kjo masë është e domosdoshme të realizohet. Po ashtu, ligji aktual i zhurmave është i përfaruar me direktivën kuadër të BE-së për zhurmat në pjesën më të madhe të tij. Një analizë e kuadrit ligjor ekzistues bëhet në kapitujt përkatës të këtij plani veprimi.

Përgatitja e hartave të zhurmave është një tjetër hap që duhet të ndiqet në të ardhmen, pas hartimit të planeve të veprimit në nivel kombëtar edhe në nivel lokal. Kjo është e domosdoshme dhe e pashmangshme, pasi hartimi i planit të veprimit krijon mundësinë e përmbushjes së shumë standardeve dhe ndërmjet tyre dhe të hartave të zhurmave.

Hartat e zhurmave përmbajnë më shumë elemente për një zonë të caktuar. Ato japin me ngjyra të caktuara dhe të diferencuara zonat ku lejohet apo ndalohet një nivel i caktuar i zhurmës.

Qëllimi i planit të veprimit

Nëpërmjet këtij plani veprimi synohet të bëhet një analizë e situatës aktuale, të përgjegjësive institucionale dhe të boshllëqeve ekzistuese ligjore dhe organizative, si dhe të planifikohen masa të domosdoshme me afate dhe buxhet të përcaktuar për t’u ndërmarrë, me qëllim përmbushjen e detyrimeve në kuadër të ligjit për administrimin mjedisor të zhurmave, të kërkesave të direktivës bazë të Bashkimit European për zhurmat dhe të kërkesave të direktivave specifike që lidhen me këtë çështje.

Ky dokument do të shërbejë, gjithashtu, për ministrinë, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e planifikimit dhe të vendimmarrjes, që të marrin në konsideratë dhe të integrojnë në planet e tyre kërkesa specifike të përcaktuara në hartat e zhurmave dhe në planet lokale të veprimit për zhurmat.

Planin kombëtar i veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis shërben si një dokument bazë dhe orientues për hartimin e planeve lokale të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis,

kërkesë kjo që buron nga neni 8 i ligjit për administrimin e zhurmave në mjedis kanë përgjegjësitë e tyre për të ndërmarrë masat për hartimin dhe miratimin e këtyre planeve lokale nëpërmjet organeve të qeverisjes vendore, siç janë këshillat e qarkut, kompetencat e të cilëve përcaktohen në bazë të nenit 11 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Objektiva kryesore të këtij plani janë:

- Përcaktimi i burimeve që gjenerojnë zhurma, të cilat paraqesin shqetësim për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve;

- Vlerësimi i shkallës së ndikimit në secilin burim;

- Vlerësimi i kuadrit ligjor rregullator i burimeve që gjenerojnë zhurmë;

- Analiza e përgjegjësiave institucionale dhe kërkesa për përmirësime të mëtejshme;

- Politikat e BE-së për zhurmat dhe implementimi i tyre në legjislacionin kombëtar;

- Përlllogaritja e kostos së përafërt për implementimin e planit kombëtar të veprimit për zhurmat;

- Konkluzione dhe rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis.

Burimet kryesore që gjenerojnë zhurma në mjedis

Objekt i këtij plani veprimi janë sektorët kryesorë që gjenerojnë zhurma në mjedis, të cilët janë trajtuar njëkohësisht dhe nga direktivat e BE-së, që janë si më poshtë:

1. Transporti (rrugor, ajror, hekurudhor);

2. Aktivitete të shërbimit social (klubet e natës dhe diskot, baret, restorantet);

3. Pajisje dhe makineritë (përpunim metali, prerje metalesh, sharrat, gjeneratorë, elektromotorë, kompresorë, çekiçë pneumatikë etj.).

Për të përcaktuar masat e domosdoshme për administrimin e zhurmave në mjedis është e domosdoshme analiza e situatës aktuale me sektorët e mësipërm. Kuadri ligjor rregullator për secilin sektor, boshllëqet ligjore apo institucionale, masat e domosdoshme për t'u ndërmarrë etj.

KAPITULLI I TRANSPORTI

Transporti është një ndër sektorët e trajtuar gjerësisht në direktivën bazë të Bashkimit European për zhurmat. Ai përmban në vetvete transportin rrugor, transportin ajror dhe transportin hekurudhor. Secili prej këtyre sektorëve ka problematikën dhe specifikat e tij, si dhe kushtet e përgjithshme të administrimit të qëndrueshëm të zhurmave nga sektori i transportit rregullohen nga direktiva bazë e Bashkimit European për zhurmat (Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council of 25 June 2002 relating to the assessment and management of environmental noise), si dhe direktiva të tjera që rregullojnë veprimtaritë specifike, që lidhen me transportin ajror (Directive 2002/30/EC of the European Parliament and of the Council of 26 March 2002 on the establishment of rules and procedures with regard to the introduction of noise-related operating restrictions at community airports), si dhe plane veprimi të administrimit të zhurmave kombëtar apo të veçanta për sektorë të caktuar të transportit.

Ky plan veprimi analizon sektorin e transportit si një sektor të rëndësishëm dhe më impakt të ndjeshëm në gjenerimin e zhurmave në mjedis. Në vlerësimin e tij janë marrë në konsideratë situatat e përgjithshme në sektorin e transportit me veçoritë specifike që ka transporti rrugor, hekurudhor apo ajror në vendin tonë.

TRANSPORTI RRUGOR

Transporti rrugor në Shqipëri përbën sektorin kryesor të transportit sa i takon transportit të brendshëm të mallrave dhe të njerëzve. Ky transport përfshin transportin e mallrave në të gjithë territorin e vendit, përfshirë dhe eksportet dhe importet.

Transporti i pasagjerëve është, gjithashtu, pjesë e rëndësishme e transportit rrugor, i cili është tashmë i zhvilluar dhe përbëhet nga linjat interurbane dhe linjat brenda qyteteve. Linjat kryesore të transportit të njerëzve kryhen kryesisht me furgonë dhe me autobusë. Shtrirja e tyre është në tërë territorin e vendit dhe për më tepër dhe në zonat më të thella dhe më të vështira të terrenit.

RRUGËT NË SHQIPËRI SIPAS KATEGORIVE TË TYRE

Tabela nr.1

Qarqet	Gjithsej	Në varësi të Drejtorisë së Rrugëve						Rrugë rurale
		Gjithsej	Nacionale	Turistike	Miniera	Pyjore	Strategjike	
Shqipëria	13,051	3,600	2,631	566	149	123	131	9,451
Berat	507	153	146	-	-	4	3	354
Dibër	870	254	221	-	33	-	-	616
Durrës	646	165	121	29	4	-	11	481
Elbasan	1,819	359	241	37	44	-	37	1,460
Fier	860	240	185	45	3	-	7	620
Gjirokastrë	662	302	302	-	-	-	-	360
Korçë	1,421	395	289	59	-	-	47	1,026
Kukës	934	284	253	31	-	-	-	650
Lezhë	994	231	147	84	-	-	-	763
Shkodër	2,307	509	293	102	54	60	-	1,798
Tiranë	881	264	145	26	11	59	23	617
Vlorë	1,152	444	288	153	-	-	3	708

Të dhëna të MPPT-së

Qarkullimi i këtyre mjeteve në zona të ndryshme urbane dhe ato rurale përbën dhe burimin kryesor të gjenerimit të zhurmave në mjedis. Zhurmat kryesisht vijnë nga rënia e burive të mjeteve, si dhe zhurma të tjera që vijnë nga frenimi, zhurmat e motorit, zhurma nga sistemi i shkarkimit të tymrave dhe gazrave të mjeteve (marmidat) etj.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve rezulton se nga regjistrimet e muajit janar të vitit 2010, janë rreth 407 mijë mjete të regjistruara dhe rreth 297 mijë mjete në qarkullim. Siç shihet nga të dhënat e tabelës dhe nga raportimet e DPRR-së rezulton se ka një rritje të numrit të mjeteve nga viti në vit. Kjo tregon për tendencën në rritje që ka ky burim gjenerimi i zhurmave në mjedis. Për këtë arsye konsiderohet si burim kryesor i zhurmave dhe masat për eliminimin apo reduktimin e tyre përbëjnë dhe masat kryesore që lidhen me sektorin e transportit.

Pjesë e planit të veprimit për kontrollin e zhurmave nga sektori i transportit rrugor janë:

- Kontrolli i zhurmës në burim;
- Planifikimi i kontrolleve për të vlerësuar dhe monitoruar burimet e zhurmës në transportin rrugor;
- Parashikimi i masave kompensuese apo zbutëse në rastet e nivelit të lartë të zhurmave, sidomos në rastet e autostradave;
- Mirëmbajtja e sistemit rrugor;
- Përcaktimi i kufijve limit.

Nisur nga këta hapa të domosdoshëm dhe në përmbushje të tyre, është e nevojshme vlerësimi i plotë i situatës në transportin rrugor të mjeteve, rrugëve dhe impaktit që ai ka në mjedis. Në Shqipëri vitet e fundit janë ndërtuar dhe po ndërtohen një numër i konsiderueshëm rrugësh të të gjitha kategorive, si: autostrada, rrugë nacionale, ndërqytete, rurale etj. Për një vlerësim të plotë të impaktit të këtij sektori në gjenerimin e zhurmave në mjedis është me interes të vlerësohet jo vetëm situata me mjetet rrugore, por dhe me gjendjen e rrugëve në përmbushjen e standardeve mjedisore lidhur me zhurmat nga këto rrugë.

Sa u takon projekteve në të ardhmen në infrastrukturën rrugore dhe në mjetet që do të futen në territorin e Shqipërisë është e nevojshme që ato t'u nënshtrohen rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin për zhurmat dhe njëkohësisht dhe në këtë plan veprimi. Ato duhet të

përmbushin kërkesat e standardeve të lejuara, të miratuara me udhëzimin nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këto masa duhet të merren në konsideratë, gjithashtu, dhe gjendja aktuale e infrastrukturës rrugore, numri i automjeteve në qarkullim dhe popullsia e ekspozuar ndaj këtyre zhurmave.

MJETET E TRANSPORTIT SIPAS QARQEVE DHE RRETHEVE

Tabela nr.2

RRETHET	Vitet				
	2005	2006	2007	2008	2009
BERAT	11276	13182	14305	15450	16286
Berat	8458	9216	10002	10838	11401
Kuçovë	1689	2751	3025	3238	3431
Skrapar	1129	1215	1278	1374	1454
DURRËS	38365	42368	45699	48449	50464
Durrës	27710	30777	33283	35239	36482
Kavajë	6054	6552	6894	7300	7584
Krujë	4601	5039	5522	5910	6398
ELBASAN	18918	21309	22795	23974	24601
Elbasan	15021	16961	18122	18975	19381
Librazhd	1445	1628	1791	1932	2069
Gramsh	968	1065	1115	1178	1212
Peqin	1484	1655	1767	1889	1939
FIER	26372	31515	34467	36624	38066
Fier	17422	20515	22479	23856	24739
Lushnjë	7094	8682	9476	10096	10487
Mallakastër	1856	2318	2512	2672	2840
GJIROKASTËR	16503	16990	17928	19055	19645
Gjirokastrë	6283	6867	7236	7681	7701
Tepelenë	2683	1741	1818	1925	2006
Përmet	1276	1414	1500	1572	1580
Sarandë	4465	5021	5356	5775	6190
Delvinë	1796	1947	2018	2102	2168
KORÇË	18121	18644	19861	20761	21595
Korçë	10710	11625	12321	12899	13413
Ersekë	967	1013	1168	1107	1139
Devoll	2402	1897	1987	2133	2233
Pogradec	4042	4109	4385	4622	4810
KUKËS	3428	3791	4012	4255	4366
Kukës	2026	2239	2384	2518	2522
Has	771	845	864	918	949
Tropojë	631	707	764	819	895
LEZHË	11582	12643	13667	14741	15433
Laç	4880	5251	5615	5934	6106
Lezhë	5222	5837	6386	6957	7331
Mirditë	1480	1555	1666	1850	1996
PESHKOPI	5709	6070	6390	6786	7147
Peshkopi	2639	2770	2877	3024	3208
Bulqizë	1156	1231	1326	1443	1516
Burrel	1914	2069	2187	2319	2423

SHKODËR	20485	20976	23614	29297	30879
Shkodër	18179	18398	20824	25989	27397
Malësi e Madhe	1432	1657	1828	2205	2339
Pukë	874	921	962	1103	1143
TIRANË	97663	111783	124083	135799	144280
VLOREË	16233	21076	22805	22869	25219

Të dhëna të MPPT-së

Nga tabela e mësipërme jepet një informacion i vlefshëm për të parë dhe vlerësuar sesi janë të shpërndarë mjetet rrugore në bazë qarku dhe rrethi, dhe të krahasuar me numrin e popullsisë, bëhet vlerësimi i impaktit që ka ky transport për secilin qark dhe rreth. Nga të dhënat e mësipërme shihet se qarku i Tiranës, Durrësit, Fierit, Shkodrës, Elbasanit etj., përmbajnë numrin më të madh të mjeteve të transportit rrugor.

KLASIFIKIMI I MJETEVE SIPAS FUNKSIONEVE TË TYRE

Tabela nr.3

Nr.	Emërtimi	Viti	
		2008	2009
	Gjithsej	378060	397981
1	Autovetura	264828	281236
2	Mikrobusë, autobusë	6645	6594
3	Kamionë + A.T.P.	79054	79905
4	Makineri bujqësore	1987	1969
5	Motomjete	18329	20874
6	Rimorkio	7217	7403

Të dhëna të MPPT-së

Për të vlerësuar këtë burim, është i nevojshëm kontrolli periodik i mjeteve për zhurmat që ato gjenerojnë. Deri tani, në praktikën e kontrollit periodik dhe rregullorja e këtij kontrolli nuk përmban kontrollin teknik për zhurmat.

KONTROLI TEKNIK VJETOR DHE PERIODIK I MJETEVE RRUGORE (3-5 TONË)

Tabela nr.4

Nr.	Objekt i kontrollit teknik periodik	Kërkesa specifike
1.	Boria	Kontroll i pasigurt, boria është montuar në mënyrë të pasigurt, nuk funksionon në mënyrë korrekte; nuk është montuar fare apo nuk funksionon.
2.	Fshirëset dhe larëset e xhamave	
3.	Shpejtësimatësi	
4.	Dritat e pasme / dritat e targës	
5.	Sinjalizuesit / indikatorët	
6.	Dritat anësore	
7.	Targa, numri i shasisë	
8.	Gazrat e shkarkimit - diesel	
9.	Gazrat e shkarkimit - benzinë	
10.	Gjendja e fenerëve	
11.	Fokusi i fenerëve	
12.	Dritat e mjegullës / dytësore / ndihmëse	
13.	Fokusi i dritave të mjegullës / dritat ndihmëse	
14.	Reflektorët	
15.	Lëngu i frenave	

16.	Sistemi elektrik	
17.	Sistemi i shkarkimit / zhurmat/ silenciatori	Montuar keq ose ka mundësi të bjerë, mungon ose nuk funksionon nivel i lartë zhurmë; rrjedhje të mëdha.
18.	Xhoko e rrotës së parë	
19.	Xhoko e rrotës së pasme	
20.	Performanca e suspensioneve të aksit të parë	
21.	Performanca e suspensioneve të aksit të pasëm	
22.	Sistemi i frenimit	Forca frenuese e mjetit është më pak se 55%; frenat nuk mund të shtypen në mënyrë progresive; frenat demonstrojnë vonesë jonormale; forca frenuese është më pak se 25 kgf.
23.	Sistemi i frenimit (disbalanca)	
24.	Performanca e frenave të parkimit (stacionare)	
25.	Frenat e parkimit (disbalanca)	
26.	Dritat e frenave	
27.	Pedali i frenave	

Siç shihet nga manuali i kontrollit teknik periodik i mjeteve, nga 27 indikatorë vetëm tre prej tyre kanë lidhje me emetimin e zhurmave në mjedis, siç janë buria, shkarkimi i gazrave ose marmidat dhe sistemi i frenimit. Nga këta tre indikatorë në këtë manual vetëm për shkarkimin e gazrave ka kërkesa për zhurmat duke konstatuar vetëm nivel të lartë të zhurmave, por pa iu referuar normave që mund të konsiderohen të larta. Për këtë arsye, në kushtet e kontrollit teknik duhet të përfshihen edhe kërkesa specifike për nivelin e emetuar të zhurmave nga mjetet e transportit të krahasuar me standardet e lejuara, duke përfshirë buritë dhe sistemin e frenimit.

Ky kontroll teknik duhet të përmbajë vlerësimin e nivelit të zhurmave në raport me ato të lejuara dhe për rastet e mospërmbushjes së tyre mjetet nuk duhet të pajisen me lejen e qarkullimit vjetor.

Në zbatim të ligjit për administrimin e zhurmave në mjedis, neni 16, pikat 1, 2 dhe 3, duhet që mjetet të kolaudohen për nivelet e emetimit të zhurmave në mjedis dhe ministrat përgjegjës për mjedisin dhe transportin duhet të hartojnë dhe miratojnë udhëzimin përkatës për procedurat e kolaudimit dhe kontrollit teknik të mjeteve të transportit për zhurmat.

Sa i takon monitorimit të zhurmave të gjeneruara nga mjetet e transportit rrugor, kërkon ngritjen e një strukture të tillë dhe vendosjen e stacioneve të monitorimit. Monitorimi i zhurmave duhet të bëhet pjesë e skemës kombëtare të monitorimit dhe në përputhje me metodikat përkatëse të përzgjidhen pikat më përfaqësuese për të bërë të mundur grumbullimin e të dhënave dhe përpunimin e tyre.

Aktualisht ky sistem nuk ekziston gjë, që nënkupton se për ngritjen e tij është e nevojshme:

- Vlerësimi paraprak i situatës së zhurmave, burimeve që gjenerojnë zhurma dhe kërkesat specifike, që kanë zona të caktuara urbane ndaj zhurmave;

- Përcaktimi i numrit minimal të stacioneve të monitorimit të zhurmave dhe i pajisjeve të domosdoshme që duhen për këtë proces;

- Përcaktimi i metodologjisë, frekuencave të matjes dhe mënyra e raportimit të të dhënave.

Përgjegjësitë për monitorimin e mjedisit janë të MMPAU-së nëpërmjet AKM-së. Për këtë arsye janë këto dy institucione që përgjigjen për përmbushjen e kërkesave të mësipërme për vlerësimin dhe ngritjen e sistemit të monitorimit të zhurmave nga transporti rrugor dhe nga burime të tjera të trajtuar në këtë plan veprimi.

Analiza e kuadrit ligjor që rregullon zbatimin e kërkesave të ligjit për zhurmat në sektorin e transportit

Kuadri ligjor që rregullon transportin rrugor përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Ligji nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacionit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, ndryshuar me udhëzimin nr.6371, datë 17.2.2004 “Rregullore e sigurimit teknik”.

Nga analiza e këtij kuadri ligjor shihet se në zbatim të ligjit për administrimin dhe vlerësimin e zhurmës në mjedis, sa i takon sektorit të transportit ka boshllëk ligjor, që lidhet me procedurat e kontrollit teknik të zhurmave nga mjetet e transportit, mungon udhëzimi përkatës për këtë qëllim.

Po ashtu mungon udhëzimi për kontrollin teknik të mjeteve të reja, të cilat, para se të futen në treg duhet të jenë të pajisura me certifikatën përkatëse të nivelit të emetimit të zhurmave në mjedis.


Ndryshime ligjore kërkohen të bëhen dhe në legjislacionin që lidhet me monitorimin e zhurmave në mjedis dhe përcaktimi i indikatorëve dhe burimeve që gjenerojnë zhurmë që duhet të jenë pjesë e procesit të monitorimit.

Përmirësime dhe ndërhyrje duhen bërë, gjithashtu, dhe në Kodin Rrugor dhe ligjin për transportin rrugor. Këto ndryshime duhet të prekin dhe kërkesa specifike për rregullat e qarkullimit rrugor sa u takon zhurmave në mjedis. Për këtë qëllim është e domosdoshme parashikimi i ndërhyrjeve në sinjalistikën rrugore dhe përfshirja në të e sinjaleve që lidhen me zhurmat, si dhe vendosjen e këtyre sinjaleve në pika të caktuara.

DISA TABELA TË SINJALISTIKËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHURMAT

Foto nr. 1





Siç shihet nga sinjalistika ndërkombëtare e mësipërme, ato përmbajnë një informacion të qartë dhe specifik për rastet dhe zonat ku lejohet ose nuk lejohet, për nivelin e zhurmave, si dhe për raste të tjera specifike. Shenja e parë tregon për ndalimin e zhurmave në rastet kur abuzohet me to. Shenja e dytë tregon për ndalimin e rënies së burive. Kjo kërkesë lidhet me zona apo segmente të caktuara të rrugëve. Shenja e tretë tregon për një zonë me zhurmë të lartë dhe ku publiku njoftohet të marrë masat për mbrojtjen e sistemit të dëgjimit. Shenjat e tjera tregojnë për kërkesa të veçanta për zhurmat që lejohen apo nuk lejohen, të lidhura ngushtë me kërkesa specifike të zonave të caktuara.

Analizë e kërkesave të direktivave europiane për transportin rrugor dhe zhurmat e gjeneruara nga ky sektor

Kërkesat specifike lidhur me transportin rrugor dhe nivelet e lejuara të zhurmave nga ky transport përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit Europian për administrimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis (Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council, of 25 June 2002, relating to the assessment and management of environmental noise). Direktiva europiane për zhurmat dhe, veçanërisht, për zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit rrugor, kërkojnë që plani i veprimit për administrimin mjedisor të zhurmave nga ky sektor të përmbushë një sërë objektivash, siç janë:

- Identifikimi i zonave me efekte më të theksuara të zhurmave dhe popullsia e ekspozuar nga këto pika;
- Identifikimi i pikave ku janë ndërtesa të ndjeshme (spitale, shkolla, çerdhe, kopshte etj.);
- Përcaktimi dhe vlerësimi i masave për reduktimin e zhurmave që shkaktojnë shqetësime ndaj popullsisë;
- Përcaktimi i kostove të nevojshme për këto ndërhyrje.

Përgjegjësitë institucionale në administrimin e zhurmave në sektorin e transportit

Administrimi i zhurmave në mjedis, sa i takon sektorit të transportit, është i lidhur me ministrinë përgjegjëse për sektorin e transportit, që aktualisht është MPPT-ja, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor. Këto institucione janë përgjegjëse për iniciativat ligjore lidhur me përmbushjen e kërkesave të direktivave europiane për nivelet e lejuara të zhurmave në mjedis nga mjetet e transportit, si dhe të organizimit dhe funksionimit të sistemit të kontrollit, kolaudimit dhe të sinjalistikës rrugore për zhurmat në mjedis.

Ministria përgjegjëse për mjedisin është për zbatimin e masave që lidhen me monitorimin e zhurmave, që ka të bëjë me përcaktimin e indikatorëve të zhurmave, sistemin e monitorimit, funksionimin e këtij sistemi, si dhe të raportimit periodik të rezultateve të monitorimit të zhurmave në mjedis.

Ministria përgjegjëse për shëndetin ka, gjithashtu, një sërë detyrimesh që lidhen me masat e domosdoshme për të garantuar shëndetin e njerëzve nga zhurmat e gjeneruara nga ky sektor, si dhe me masat e domosdoshme që duhen ndërmarrë në këtë drejtim. Kjo ministri duhet të bëjë vlerësime të shkallës së ndikimit të zhurmave në shëndetin e njerëzve dhe të propozojë masa specifike të domosdoshme, duke u përqendruar në kërkesat e veçanta që kanë objektet, si: shkolla, spitale, kopshte, çerdhe etj.

**MASA TË DOMOSDOSHME PËR T'U NDËRMARRË NË FUSHËN E TRANSPORTIT
RRUGOR**

Tabela nr.5

Nr.	Masat që duhen ndërmarrë	Institucioni përgjegjës	Afati (viti)
1.	Identifikimi i zonave dhe akseve rrugore që kanë ndikim të theksuar të zhurmave ndaj popullsisë.	MPPT, MSH, MMPAU	2012
2.	Identifikimi i zonave të ndjeshme ku ndodhen ndërtesat me kërkesa të veçanta për nivelin e zhurmave (spitale, shkolla, kopshte dhe çerdhe).	MPPT, MASH, MSH, Njësitë vendore	2012
3.	Hartimi i planit të masave për reduktimin e zhurmave të gjeneruara nga transporti rrugor.	MPPT	2011
4.	Përcaktimi i kostove të nevojshme për implementimin e masave për reduktimin e zhurmave nga sektori i transportit rrugor.	MPPT	2012
5.	Përfshirja e kërkesave specifike për zhurmat në projektet e ndërtimit të rrugëve (nacionale, ndërqytetëse dhe urbane).	MPPT, MMPAU	Vazhdimisht
6.	Ndërhyrja në akset rrugore ekzistuese me masa konkrete për reduktimin e nivelit të zhurmave në mjedis në zbatim të planit të reduktimit të tyre: - Rrugët nacionale dhe autostradat; - Rrugët ndërqytetëse; - Rrugët rurale.	MPPT	2012 e në vazhdim
7.	Përmirësime të kuadrit ligjor: Përfshirja në Kodin Rrugor të kërkesave specifike për kontrollin e zhurmave në transportin rrugor. Hartimi i udhëzimit të përbashkët për kontrollin teknik të mjeteve për zhurmat. Ndryshime në ligjin për transportin rrugor për çështje që lidhen me sistemin e sinjalistikës rrugore për zhurmat, si dhe i udhëzimit dhe rregullores për kontrollin periodik të mjeteve.	MPPT, MMPAU, MSH	2011 2011 2012

TRANSPORTI AJROR

Transporti ajror në Shqipëri është funksional vetëm në Tiranë dhe është i destinuar vetëm për transportin civil. Aktualisht ka përfunduar edhe aeroporti i Kukësit, i cili deri tani nuk ka filluar, por mund të fillojë në të ardhmen.

Sipas projekteve të MPPT-së për zhvillimin e sektorit të transportit ajror është në plan dhe ndërtimi i një aeroporti në Sarandë. Ky aeroport do të konceptohet më tepër si aeroport turistik dhe me kapacitet të kufizuar.

Aeroporti “Nënë Tereza” është një aeroport i dhënë me koncesion një kosorciumi, që ka në përbërje tri kompani (hohtief AirPort GmbH, Deutsche investitions-und entwicklungsgesellschaft dhe Albanian- American Enterprise Fund). Ky aeroport është i vetmi që bën një monitorim të rregullt të mjedisit dhe veçanërisht të zhurmave të emetuara nga ky aeroport prej tre vjetësh.

TË DHËNA MBI NUMRIN E FLUTURIMEVE DHE TË PASAGJERËVE NGA AEROPORTI I RINASIT

Tabela nr.6

Viti	Numri i fluturimeve	Numri i pasagjerëve
2005	15, 400	785 000
2006	15, 856	906,103
2007	18, 250	1,105, 770
2008	19,194	1,267,041
2009	20,064	1,394,688
2010 (deri në muajin tetor)	9,360	644,914

Të dhëna publikuar në webside-in e aeroportit “Nënë Tereza”

Nga të dhënat e tabelës për tri vitet e fundit shihet se fluksi i fluturimeve dhe i pasagjerëve në aeroportin e Rinasit është rreth 50-60 avionë në ditë dhe rreth 3500 pasagjerë çdo ditë. Po ashtu duket qartë se ka një fluks në rritje nga viti në vit, si të numrit të fluturimeve dhe të pasagjerëve.

Në përputhje me lejen mjedisore të TIA-s dhe procedurave të monitorimit mjedisor, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës zbaton programin e monitorimit të zhurmave për të vlerësuar nivelet e zhurmave në aeroport dhe në afërsi të tij.

Figura nr.2 Pozicionet e monitorimit të zhurmave në aeroportin “Nënë Tereza”



Monitorimi i zhurmave kryhet mbi bazën e pozicioneve të konsideruara si më përfaqësuese dhe më strategjike brenda dhe jashtë zonës së aeroportit gjatë sezonit të pikut, si dhe jashtë tij. Matjet 24-orëshe u klasifikuan në tri periudha: orët e ditës 07:00-19:00, orët e mbrëmjes 19:00-23:00 dhe orët e natës 23:00-07:00 Matjet e zhurmave kryhen në përputhje me ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” dhe me direktivën 2002/30/EC e Parlamentit European (PE) dhe Këshillit të BE-së të datës 26 mars 2002 për vendosjen e rregullave dhe procedurave në lidhje me përhapjen dhe kufizimin e zhurmave në aeroport. Gjatë këtij procesi u përdorën dy modele aparaturash për matjen e nivelit të zhurmave në pozicione specifike.

Të dhënat e këtij sistemi monitorimi të zhurmave nga aeroporti “Nënë Tereza” jepen në tabelat më poshtë:

Tabela nr.7

Poz. e matjeve	Faza I-LAeq (dB A)			Faza II- LAeq(dB A)		
	ditë	mbrëmje	natë	ditë	mbrëmje	natë
poz. 1 A	45.9	54.2	50.5	50.5	49.8	47.6
poz. 1 B	51.4	50.6	48.4	49.7	49.7	47.3
poz. 2 A	56.7			56.4		
poz. 2 B	54.2	47.4	43.8	55.8		
poz 3A	53	49.4	48.4	53.9	46.4	46.2
poz 3 B	52.2			55.4		
poz. 8	68	63.9	65.1	68.6		
poz. 6	66	60	64.1	61.1	55.8	56.5
poz. 4	52.8	52.1	51.9	50.5	51.7	48.7
poz. S.E	69.7			67.6	58.1	49.1

Tabela nr.8

Poz. e matjeve	Faza I -LAmx (dB A)			Faza II- LAmx (dB A)		
	ditë	mbrëmje	natë	ditë	mbrëmje	natë
poz. 1 A	91	82	83	89.6	91.7	78.4
poz. 1 B	92	87	91	86.9	81.6	88.2
poz. 2 A	90.2			91.5		
poz. 2 B	92	88	83	92.1		
poz. 3 A	99	93	95	94.1	91.7	89.2
poz. 3 B	103			82.1		
poz. 8	98	103	98	84.6		
poz. 6	94	90	90	86.4	84.8	84
poz. 4	96	92	93	87.2	93.2	86
poz. S.E	89.7			100.8	93	83.2

Nga të dhënat e raportuara nga ky institucion rezulton se niveli i emetuar i zhurmave është në normat e lejuara të zhurmave në vendin tonë. Megjithatë transporti ajror përbën një ndër sektorët me rritje të dukshme si të numrit të fluturimeve, dhe të pasagjerëve. Këta dy faktorë janë të mjaftueshëm për të konkluduar se është një sektor, të cilit duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë. Megjithëse sistemi i monitorimit tregon për nivele të lejuara të zhurmave, kjo nuk është e mjaftueshme për të justifikuar masat e marra deri më sot. Për këtë sektor është e nevojshme të bëhet vlerësimi i numrit të popullsisë të ekspozuar ndaj këtyre zhurmave dhe veçanërisht e banorëve të zonave përreth aeroportit, si dhe të institucioneve të ndjeshme ndaj zhurmave, siç janë: shkollat, çerdhet, kopshtet etj.

Analizë e kuadrit ligjor rregullator për administrimin e zhurmave nga sektori i transportit ajror

Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e transportit ajror përbëhet nga:

- Ligji nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr.9255, datë 15.7.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për unifikimin e disa rregullave për transportin ajror ndërkombëtar””;
- Vendimi nr.1214, datë 3.9.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit”;
- Udhëzimi nr.9, datë 3.6.2010 “Për kërkesat e përbashkëta të dispozitës së shërbimeve të navigimit ajror”.

Kuadri ligjor ekzistues, ashtu si dhe për fushat e tjera nuk ka kërkesa specifike për zhurmat nga transporti ajror. Në këto rrethana është e nevojshme:

- Rishikimi i këtij kuadri ligjor dhe përfshirja në të e kërkesave që lidhen me këtë sektor dhe që përcaktohen nga direktivat e BE-së.

- Të bëhet rivlerësimi i skemës së monitorimit në raport me ndikimin që ka në popullsinë përreth aeroportit në kushtet e rritjes së numrit të fluturimeve;

- Të hartohen dhe ndërmerren masat e domosdoshme për minimizimin e nivelit të zhurmave në mjedis;

- Të mbahen regjistrat përkatës të rezultateve të monitorimit të nivelit të zhurmave.

Analizë e kërkesave të direktivave europiane për zhurmat nga transporti ajror

Kërkesat e direktivave të BE-së për transportin ajror përcaktohen nga direktiva “Directive 2002/30/EC of the European Parliament and of the Council of 26 March 2002, on the establishment of rules and procedures with regard to the introduction of noise-related operating restrictions at Community airports”.

Kjo direktivë parashikon një sërë masash që duhen ndërmarrë për të administruar dhe kontrolluar nivelin e zhurmave në mjedis që lidhen me:

- masat që duhet të ndërmarrin vendet anëtare për të reduktuar zhurmat dhe numrin e njerëzve të ekspozuar ndaj zhurmave të shkaktuara nga trafiku ajror;

- vlerësimin e grupeve të interesit dhe të kërkesave të tyre që janë nën ndikimin apo mund të ndikohen nga zhurmat e shkaktuara nga trafiku ajror;

- ndërmarrjen e masave të domosdoshme nga vendet anëtare për të minimizuar dhe reduktuar efektet negative të shkaktuara nga zhurmat në mjedis nga trafiku ajror.

Këta përbejnë objektivat kryesorë të kësaj direktive, arritja e të cilëve kërkon të ndërmerren masa konkrete dhe të monitorohet implementimi i këtyre masave në vazhdimësi.

Përgjegjësitë institucionale në administrimin mjedisor të zhurmave nga transporti ajror

Nisur nga analiza e kuadrit ligjor ekzistues, shihet se përgjegjësitë institucionale në administrimin e këtij sektori është ministria përkatëse për transportin, aktualisht MPPT-ja. Ministria është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave kryesore që lidhen me këtë sektor.

Pjesë e rëndësishme në menaxhimin e sektorit të transportit ajror është dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Planifikimit të Transportit, si dhe Drejtoria e Politikave të Transportit Ajror, pjesë të MPPT-së.

Një institucion tjetër i rëndësishëm i organizuar në formën sh.a., është dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror sh.a. (ANTA). Kjo agjenci ka për mision: të sigurojë shërbime të trafikut ajror të sigurta, me cilësi të lartë, që nuk cenojnë mjedisin, internacionalist konkurruese dhe që zhvillohen në mënyrë dinamike, si dhe të kontribuojë në kërkesën e sigurisë kombëtare për të mbrojtur sovranitetin e hapësirës ajrore kombëtare.

**MASAT E DOMOSDOSHME PËR T'U NDËRMARRË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT
AJROR**

Tabela nr.9

Nr.	Masat për t'u ndërmarrë	Institucioni përgjegjës	Afati (viti)
1.	Përafrimi i kuadrit ligjor për transportin ajror me direktivën e BE-së, duke përfshirë këto kërkesa në Kodin e Republikës së Shqipërisë për transportin Ajror,	MPPT, MMPAU, MSH	2011
2.	Vlerësimi i numrit të popullsisë të ekspozuar nga zhurmat e gjeneruara nga trafiku ajror dhe ndërmarrja e masave për reduktimin e zhurmave	MPPT	2011
3.	Hartimi i planeve të menaxhimit të zhurmave në nivel aeroporti	MPPT	2012

TRANSPORTI HEKURUDHOR

Situata aktuale me transportin hekurudhor, problematika e tij në Shqipëri

Shqipëria ka një rrjet hekurudhor, i cili shtrihet në akset veri jug dhe në aksin lindje-perëndim. Linjat hekurudhore lidhin qytetet kryesore të Shqipërisë dhe konkretisht, qytetet e Vlorës, të Fierit, Lushnjës, Kavajës, Durrësit, Tiranës, Lezhës, Shkodrës, Elbasanit, Pogradecit. I gjithë rrjeti hekurudhor i vendit është 447 km.

Ky rrjet transporti kalon në zonat kryesore urbane të vendit ose në afërsi të tyre. Qytetet nëpër të cilat kalon ky rrjet hekurudhor dhe popullsia potencialisht e ekspozuar nga zhurmat e gjeneruara nga transporti hekurudhor mund të vlerësohen përafërsisht në tabelën mbi numrin e popullsisë sipas qyteteve të vendit tonë.

NUMRI I LOKOMOTIVAVE DHE VAGONËVE TË UDHËTARËVE NË SHQIPËRI (2005-2009)

Tabela nr.10

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet				
			2005	2006	2007	2008	2009
1	Lokomotiva gjithsej (diezel)	copë	58	58	57	57	55
	Lokomotiva në përdorim		25	25	24	24	22
	Lokomotiva në konservim		33	33	33	33	33
	" "	mijë kf	73.4	73.4	72.03	72.03	70.44
2	Vagonë udhëtarësh	copë	86	67	88	88	88
	Vagonë udhëtarësh në përdorim	copë	76	53	43	43	43
	" "	mijë vende	6.3	4.01	3.32	3.32	3.32
3	Vagonë mallrash gjithsej	copë	824	824	710	710	537
	" " "	mijë tonë	39.0	36.9	32.0	32.0	23.1
a	Vagonë të mbuluar	copë	242	142	142	142	72
	" "	mijë tonë	11.224	5.78	5.724	5.724	1.68
b	Vagonë me sponte të larta	copë	371	305	200	200	173
	" "	mijë tonë	16.095	10.65	6.704	6.704	5.555
c	Vagonë me sponte të sheshtë	copë	93	259	250	250	215
	" " "	mijë tonë	6.666	14.39	13.926	13.926	11.926
d	Vagonë të tjerë cisternë + qypa)	copë	118	118	118	118	77
	" "	mijë tonë	6	6.1	5.7	5.7	3.9

Të dhëna të MPPT-së

MJETET HEKURUDHORE DHE VËLLIMI I TRANSPORTIT TË TYRE


Tabela nr.11

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Vitet				
			2005	2006	2007	2008	2009
	UDHËTARË						
1	Vëllimi i punës	000 udh	1439.95	1658.84	1090.88	822.615	645
2	" "	000 ukm	73001.53	79613.45	50774.63	40548	31524
3	Mjete ditë në inventar	MDI	32120	23508	19345	19652	15940
4	Mjete ditë në punë	MDP	15503	10838	7984	7365	6139
5	Mjete vende dite në inventar	MVDI	2379070	1670006	1463285	1454742	1E+06
6	Mjete vende dite në punë	MVDP	1180622	776689	586553	542343	451575
7	Koeficienti i gad.teknike	%	87	88.7	85.5	93.8	89.5

Të dhëna të MPPT-së

NUMRI I PASAGJERËVE TË TRANSPORTUAR NGA TRANSPORTI HEKURUDHOR

Grafiku nr.1



Nga të dhënat e tabelave mbi numrin e mjeteve dhe vagonëve në vite shihet se numri i tyre në përgjithësi është në rënie nga një vit në tjetrin, po ashtu dhe numri i pasagjerëve dhe mallrave të transportuara nëpërmjet hekurudhës është në rënie. Kjo tregon se ky sektor në përgjithësi ka tregues në rënie. Megjithatë lidhur me gjenerimin e zhurmave treguesit mund të jenë në rritje, pasi kemi të bëjmë me mjete të vjetruara dhe të amortizuara, si dhe me rrjet hekurudhor të amortizuar, pasi dhe investimet në këtë sektor vitet e fundit kanë qenë tepër të ulëta.

Nga analiza e ndikimit të rrjetit hekurudhor dhe të zhurmave që ai shkakton rezultojnë se në përgjithësi ai kalon në një zonë të dendur urbane dhe nën ndikimin e tij është një popullsi, e cila në numër shkon në një nivel të konsiderueshëm. Duke përllogaritur numrin apo frekuencën e lëvizjes së trenave, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian, shihet se ato janë në nivele të ulëta. Vlerësuar edhe në aspekte të tjera që lidhen me gjendjen teknike të hekurudhave dhe të trenave, rezultojnë se zhurmat e gjeneruara nga ky sektor edhe pse në raport me vendet e Bashkimit Europian dhe të direktivës së zhurmave janë më të ulëta zhurmat e gjeneruara janë relativisht të larta. Në këto kushte është e nevojshme rishikimi i situatës në të gjithë territorin e vendit dhe në procesin e hartimit të hartës së zhurmave të merren në konsideratë këta faktorë. Shqipëria nuk ka trena të shpejtësive të mëdha dhe për rrjedhojë dhe kërkesat specifike të direktivës europiane për këta trena nuk paraqesin interes për vendin tonë. Nëse në të ardhmen do të ndërtohen linja hekurudhore të

trenave të shpejtësive të mëdha, natyrisht, në kushtet e ndërtimit të tyre duhet të parashikohen kërkesa specifike për reduktimin apo kontrollin e zhurmës në mjedis.

Analizë e kuadrit ligjor rregullator për sektorin e transportit hekurudhor

Kuadri ligjor që rregullon transportin hekurudhor në vendin tonë lidhet me legjislacionin e transportit. Në këtë grup aktesh ligjore mund të përmenden:

- Ligji nr.9689, datë 5.3.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen Europiane për linjat hekurudhore ndërkombëtare kryesore””;

- Ligji nr.9300, datë 28.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në shtojcën “a” të konventës për transportin ndërkombëtar hekurudhor (COTIF) “Për rregullat uniforme për kontratën e transportit ndërkombëtar hekurudhor të udhëtarëve dhe të bagazheve (CIV)”;

- Ligji nr.9167, datë 22.1.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë””;

- Ligji nr.9168, datë 22.1.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për udhëtarët dhe bagazhet e transportuara me hekurudhë”” (Gjenevë, 10 janar 1952).

Nga analiza e hollësishme e këtij kuadri ligjor rregullator shihet si legjislacioni i hartuar që i përgjigjet sektorit të transportit hekurudhor është përqendruar kryesisht në përmbushje të kërkesave të konventave ndërkombëtare që rregullojnë transportin hekurudhor dhe veçanërisht atë ndërkufitar dhe ndërkombëtar. Sa u takon kërkesave specifike për transportin hekurudhor dhe veçanërisht të kërkesave për kufizimin e zhurmave në mjedis në zona të caktuara, shihet se ai nuk përmban asnjë detyrim.

Po ashtu nga analiza e sinjalistikës së transportit hekurudhor, shihet se nuk ka kërkesa specifike për të udhëzuar drejtuesit e trenave për të kufizuar apo ndaluar rënien e burive apo sirenavë të trenit në zona të caktuara.

Zhurmat e gjeneruara nga sektori i transportit hekurudhor nuk janë vetëm ato të sirenavë, por edhe zhurmat nga frenimet, zhurmat që gjenerohen nga gjendja jo e mirë teknike e vetë sistemit hekurudhor.

Lidhur me administrimin mjedisor të zhurmave në mjedis, përveç direktivës bazë europiane që rregullon administrimin e zhurmave për sektorin e transportit hekurudhor, ka direktivë të veçantë.

Në kërkesat specifike të respektimit të nivelit të zhurmave nga sektori i transportit hekurudhor, përveç nivelit të zhurmave janë dhe kontrolli i vibrimeve apo dridhjeve që shkaktohen gjatë akteve hekurudhore dhe veçanërisht pranë qendrave të banuara.

Kërkesa të direktivave të bashkimit europian për administrimin e zhurmave nga sektori i transportit hekurudhor

Kërkesat e përgjithshme për transportin hekurudhor përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit Europian për administrimin e zhurmave në mjedis (Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council, of 25 June 2002, relating to the assessment and management of environmental noise). Në raport me kërkesat e kësaj direktive, kërkohet që çdo vend anëtar të bëjë vlerësimin e impaktit që ka transporti hekurudhor në emetimin e zhurmave në mjedis, marrjen e masave zbutëse ndaj tyre dhe hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për sektorin e transportit hekurudhor për administrimin e qëndrueshëm të zhurmave në mjedis.

Masat që duhen ndërmarrë për përmirësimet ligjore dhe institucionale

Lidhur me administrimin e zhurmave në sektorin e transportit hekurudhor, kërkohen të bëhen disa ndërhyrje. Këto ndërhyrje lidhen me kuadrin ligjor dhe atë rregullator. Hekurudhat dhe trenat janë pronë publike, por në kuadër të transportit ndërkombëtar dhe ndërkufitar lind nevoja e unifikimit të procedurave dhe standardeve.

Për këtë qëllim është i nevojshëm vlerësimi i akteve që kalojnë pranë qendrave urbane. Në këto akte është nevojshme të bëhen përmirësime të sinjalistikës dhe të vendosen tabelat përkatëse që tregojnë për ndalimin e rënies së sirenavë apo për kufizimin e tyre në zona të tjera. Kjo duhet të

bëhet në përputhje me kërkesat e direktivës europiane dhe me numrin e popullsisë të ekspozuar ndaj këtyre zhurmave.

Një tjetër fushë e përmirësimeve lidhur me transportin hekurudhor janë dhe dridhjet apo vibrimet që shkaktohen gjatë lëvizjes së trenave. Për këtë qëllim autoritetet përkatëse duhet të bëjnë matjet dhe në përputhje me gjendjen e hekurudhave, trenave dhe popullsinë që ekspozohet ndaj këtyre dridhjeve të ndërmerren masat përkatëse.

PLANI I MASAVE QË DUHEN NDËRMARRË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT HEKURUDHOR

Tabela nr.12

Nr.	Masat për t'u ndërmarrë	Institucioni përgjegjës	Afati (viti)
1.	Përafrimi i direktivës së BE-së, për zhurmat nga sektori i transportit hekurudhor	MPPT, MMPAU, MSH	2012
2.	Vlerësimi i numrit të popullsisë të ekspozuar nga zhurmat e rrjetit hekurudhor dhe marrja e masave për reduktimin e tyre	MPPT	2013
3.	Vlerësimi i sinjalistikës të hekurudhave dhe përfshirja e kërkesave dhe sinjaleve specifike për zhurmat në transportit hekurudhor	MPPT	2011
4.	Hartimi i një plani masash për reduktimin e zhurmave nga sektori i transportit	MPPT	2013

KAPITULLI II SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE (DISKO, BARE, KLUBE NATE, KAFENE, RESTORANTE ETJ.)

Analizë e situatës së respektimit të kërkesave ligjore për zhurmat nga sektori i shërbimeve publike

Sektori i shërbimeve publike përbën dhe sektorin me problematik të gjenerimit të zhurmave pas atij të transportit rrugor. Kjo vjen për arsye të vetë vendndodhjes së tyre afër qendrave urbane, si dhe të kohës së zhurmave që ato gjenerojnë.

Në sektorin e shërbimeve publike përfshihen:

- bare, kafene dhe restorante;
- disko ose klube nate;
- lokale që organizojnë dasma dhe ceremoni të tjera familjare.

Këto aktivitete në pjesën më të madhe të tyre licencohen nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në kushtet e licencimit nuk ka kërkesa specifike për nivelin e lejuar të zhurmave që ato duhet të respektojnë.

Kërkesa për pajisje me leje mjedisi parashikon vetëm ligji për administrimin mjedisor të zhurmave. Edhe pse ligji ka hyrë në fuqi, ende nuk ka filluar procesi i licencimit të këtyre aktiviteteve. Ligji parashikon jo vetëm nivelet e lejuara të zhurmave, por dhe oraret e lejuara.

Masat e domosdoshme për t'u ndërmarrë për përbushjen e standardeve mjedisore dhe administrimin e qëndrueshëm të zhurmave nga sektori i shërbimeve publike

Disiplinimi i këtij sektori si më problematiku në gjenerimin e zhurmave në mjedis, kërkon të ndërmerren disa hapa konkretë që lidhen:

- Vlerësimi i situatës aktuale, vendndodhjes dhe personave të ekspozuar nga zhurmat që gjenerojnë këto aktivitete;
- Vlerësimi i kushteve specifike në licencimin e tyre;
- Parashikimi i masave për përmirësimet ligjore në legjislacionin lidhur me planifikimin e territorit dhe urbanistikën;
- Ngritja e strukturës së monitorimit dhe kontrollit të zhurmave nga ky sektor.

PLANI I MASAVE NË SEKTORIN E AKTIVITETEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE

Tabela nr.13

Nr.	Masat që duhen ndërmarrë	Institucioni përgjegjës	Afati (viti)
1.	Vlerësimi i personave të ekspozuar nga lokalet e shërbimit social (disko, bare, restorante)	MB, MF, MMPAU	2012
2.	Pajisja me leje mjedisi e këtyre aktiviteteve	MMPAU	2011
3.	Ngritja e strukturës së kontrollit dhe monitorimit të zhurmave nga sektori i shërbimeve publike	MB, MMPAU,	2011
4.	Përmirësime dhe përfshirje në legjislacionin aktual për ndërtimet dhe urbanistikën të kërkesave specifike për nivelet e lejuara të zhurmave nga këto aktivitete	Ministritë e linjës, MMPAU	2011
5.	Certifikimi i niveleve të emetuara të zhurmës nga aktivitetet ekzistuese dhe publikimi i rezultateve të tyre	MSH, MMPAU	2011

Përgjegjësia institucionale për administrimin dhe kontrollin e zbatimit të kërkesave ligjore për zhurmat nga ky sektor

Përgjegjësitë institucionale për disiplinimin e aktiviteteve që gjenerojnë zhurmë nga ky sektor, janë të lidhura me ministrinë apo autoritetin përgjegjës për licencimit. Po ashtu, shumë aktivitete të përfshira në këtë grup pajisen me leje nga autoritetet vendore. Këto autoritete duhet që në procesin e licencimit të respektojnë kërkesat e ligjit për zhurmat, si dhe kërkesa të veçanta parashikuar në hartën e zhurmave dhe të planifikimit të territorit për zona me kërkesa specifike për zhurmat.

Institucioni përgjegjës për licencimin e këtyre aktiviteteve duhet të rishikojnë dhe përmirësojnë procedurat e licencimit dhe përfshirjen në to të kërkesave specifike për respektimin e niveleve të lejuara të zhurmave të emetuara prej tyre.

MSH-ja është përgjegjëse për kontrollin e nivelit të zhurmave dhe certifikimin e tyre nëpërmjet strukturave të saj. Për këtë ministri është e nevojshme dhe emergjente ngritja e njësisë së zhurmave në Institutin e Shëndetit Publik. Kjo strukturë është kërkesë e ligjit për zhurmat dhe duhet të monitorojë dhe raportojë për zhurmat e gjeneruara në mjedis.

MMPAU-ja është përgjegjëse që nëpërmjet inspektoratit të mjedisit të kontrollojë zbatimin e kërkesave të ligjit për zhurmat e gjeneruara nga këto aktivitete, si dhe të ndërmarrë masat për respektimin e normave të lejuara.

MPPT-ja është përgjegjëse që nëpërmjet strukturave të saj dhe në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të ndërmarrë masat për përfshirjen e kërkesave specifike për zhurmat e gjeneruara nga këto aktivitete në planet lokale të zhvillimit dhe të planifikimit urban.

NUMRI I POPULLSISË SIPAS QARQEVE DHE RRETHEVE

Tabela nr.14

Qarku	Numri i popullsisë
Gjithsej	3,194,417
Berat	170,815
Dibër	140,007
Durrës	310,441
Elbasan	343,053
Fier	374,004
Gjirokastrë	102,531
Korçë	257,530
Kukës	79,289

Lezhë	158,800
Shkodër	246,016
Tiranë	800,197
Vlorë	211,734

Regjistrimi i vitit 2009 (INSTAT)

Nga të dhënat e kësaj tablele rezultojnë se qarqet me numër më të madh të popullsisë janë: qyteti i Tiranës, Shkodrës, Lushnjës, Korçës, Fierit, Elbasanit, Durrësit dhe Vlorës. Këto të dhëna mund të shërbejnë si të dhëna orientuese për të vlerësuar situatën në përgjithësi dhe, më pas për të kaluar në vlerësime konkrete për çdo aktivitet dhe për çdo zonë të një qendre të banuar urbane. Për të përcaktuar më në detaje këtë impakt në mjedis dhe në popullsinë e ekspozuar ndaj këtyre zhurmave, është e nevojshme të evidentohet saktë numri i këtyre lokaleve për secilin qytet apo zonë turistike dhe numrin potencial të popullsisë së ekspozuar ndaj këtyre zhurmave. Aktualisht nuk ka të dhëna për numrin e tyre nga INSTAT-i dhe për këtë bëhet edhe më e nevojshme evidentimi dhe regjistrimi i tyre për secilin qark, bashki dhe qytet. Për të monitoruar në të ardhmen këtë fenomen është e nevojshme që në QKL dhe QKR të ketë statistika të veçanta për këto aktivitete me qëllim monitorimin e tyre.

Kërkesa të direktivave të Bashkimit Europian për zhurmat në restorante, pabe dhe disko

Kërkesat e tyre të përgjithshme përcaktohen në direktivën bazë të Bashkimit Europian (Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council, of 25 June 2002, relating to the assessment and management of environmental noise), ndërsa kërkesa specifike ka në direktivat e veçanta që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve të ekspozuar ndaj tyre, përfshi këtu dhe personelin që shërben në këto restorante dhe disko (Directive 2003/10/EC of the European Parliament and of the Council, of 6 February 2003, on the minimum health and safety requirements regarding the exposure of workers to the risks arising from physical agents (noise).

Në këto dokumente kërkohet që nivelet e zhurmave që gjenerohen nga këto aktivitete të jenë në nivelet e lejuara dhe që nuk shkaktojnë dëmim të shëndetit të personave të ekspozuar ndaj tyre. Për këtë, çdo vend duhet të miratojë nivelet e lejuara të zhurmave dhe më pas respektimin e tyre.

KAPITULLI III

PAJISJET DHE MAKINERITË QË GJENEROJNË ZHURMË

Analiza e situatës në këtë sektor

Zhurmat e gjeneruara nga makineritë dhe veçanërisht nga pajisje të ndryshme, është një tjetër fushë ku kërkohen të merren masa specifike me qëllim të administrimit të zhurmave që në burimin e tyre.

Sektori i industrisë përfshin shumë aktivitete industriale që gjenerojnë zhurmë, por në vendin tonë ky sektor është tepër i kufizuar dhe për rrjedhojë edhe zhurmat e gjeneruara nga ai janë të papërfillshme.

Pjesa më e rëndësishme dhe njëkohësisht dhe më problematike mbetet zhurmat e gjeneruara nga pajisjet që janë ekspozuar në mjediset publike. Direktivat e Bashkimit Europian përmbajnë rreth 56 pajisje që i nënshtrohen rregullave dhe që duhet të përmbushin kërkesat për nivelet e lejuara të zhurmave që ato gjenerojnë. Kjo direktivë është e miratuar që në vitin 2000 (Directive 2000/14/EC OF the European Parliament and of the Council, of 8 May 2000, on the approximation of the laws of the Member States relating to the noise emission in the environment by equipment for use outdoors). Përgjithësisht direktiva përcakton pajisjet që janë objekt i kësaj direktive, nivelet e lejuara të zhurmave nga secila pajisje.

Në këtë grup pajisjesh përfshihen:

- gjeneratorët e tipave dhe madhësive të ndryshme;
- pajisjet e shpimit të betoneve, asfalte (matrapik, çekiçët pneumatikë, trapan etj.);
- pajisje të prerjes së metaleve dhe drurëve (sharrat, zmerilues etj.);

- pajisjet e presimit, vibrimit, rulimit;
- eskalatorët, vinçat.

Gjeneratorët përbëjnë pjesën më problematike të emetimit të zhurmave në mjedis. Si rezultat i problematikës së konstatuar në furnizimin me energji elektrike dhe për të siguruar një vazhdimësi në furnizim me energji, shumë subjekte, si: restorante, hotele, disko, lojëra fati, institucione etj., kanë instaluar gjeneratorë të madhësive të ndryshme për prodhim energjie.

GJENERATORË TË IMPORTUAR NË VENDIN TONË TRI VITET E FUNDIT (2007-2009)

Tabela nr.15

CN	Përshkrimi	Njësia	Sasia
85011010	Motor sinkron me një dalje = <18kw.	copë	805
85011091	Motor universa IAC/DC me dalje = <37.5w	copë	4,075
5011093	Motorë AC me dalje = <37.5w (jomotorë sinkronik me dalje = <18w)	copë	1,057
85011099	Motorë DC me dalje = <37.5w	copë	843
85013220	Motorët DC; gjeneratorët DC me një dalje >750w, por deri në 7.5kW	copë	1,442
85013280	Motorët DC; gjeneratorët DC me një dalje >7.5kW, por deri në 75kW	copë	125
85015220	Motor AC, shumëfazor me dalje >750w, por = <7.5kw	copë	436
85015230	Motor AC, shumëfazor me dalje >7.5kw, por = <37kw	copë	24
85015290	Motor AC, shumëfazor me dalje >37kw, por = <75kw	copë	9
85015350	Motorë traction	copë	4
85016120	Gjeneratorë AC me dalje = <75kva (jo: për aviacion civil të nënkorrëve 850161-10)	copë	89
85016180	Gjeneratorë AC me dalje >7.5 kva, por = <75kva (jo:aviacion civil të nënkorrëve 850161-10)	copë	17
85016200	Gjeneratorët AC me dalje >75 kva, por = < 375 kva	copë	12
85016300	Gjeneratorët AC me një dalje > 375kva, por < =750kva	copë	6
85016400	Gjeneratorë AC me dalje >750kva	copë	23
85021120	Grup gjenerator, motor me piston me djegie të brendshme, tip shtypje-djegje, dalje = <7.5kva	copë	126
85021180	Grup gjenerator, motor me djegie të brendshme, tip shtypje-djegje, dalje >7.5kva, deri 75kva	copë	170
85021200	Grup gjeneratorët me motor djegie të brendshme, dalja >75kva, por = <375kva, për avion civil	copë	87
85021290	Grup gjenerator, motor me djegie të brendshme, diesel/gjysmë, dalje >75kva, por = <375kva	copë	1
85021320	Grup gjenerator, motor me djegie të brendshme, diesel/gjysmë, dalje >375kva, por = <750kva	copë	34
85021340	Grup gjenerator, motor me djegie të brendshme, diesel/gjysmë, dalje >750kva, por = <2000kva	copë	14
85021380	Grup gjeneratorët me motor me djegie të brendshme me kompresion-ndezje, me dalje >2000kva	copë	1
85022020	Grup gjenerator, motor me djegie të brendshme, piston me shkëndijë me dalje = <7.5kva	copë	41
85022040	Grup gjeneratorë, motor me djegie të brendshme, piston me shkëndijë, dalja >7.5, por = <375kva	copë	30
85022060	Grup gjeneratorë, motor me djegie të brendshme, piston me shkëndijë, dalja >375, por = <750kva	copë	7
85022080	Grup gjeneratorë, motor me djegie të brendshme, piston me shkëndijë me dalje >750kva	copë	3
	Shuma e mjeteve të importuar në tri vitet e fundit		9481

Shënim. Të dhënat janë marrë nga DPD-ja dhe u përkasin tri viteve të fundit.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme mbi importet e gjeneratorëve të madhësive dhe fuqive të ndryshme tregon se numri i tyre është i konsiderueshëm. Vetëm tri vitet e fundit janë importuar 9481 të tillë. Këto pajisje janë të vendosura përgjithësisht në qendrat e banuara dhe në mjedise të ekspozuara ndaj publikut.

Në zbatim të kërkesave të direktivës përkatëse të BE-së duhet që makineritë që gjenerojnë zhurmë duhet të pajisen me një certifikatë të prodhuesit, e cila duhet të përmbajë dhe nivelin e zhurmave që ato gjenerojnë. Po ashtu, këto pajisje duhet të përmbajnë një informacion minimal, i cili ka të bëjë me konformitetin e pajisjes, siç janë:

- emrin dhe adresën e prodhuesit të pajisjes;
- një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes;
- prodhuar;
- emri tregtar;
- tipi, seria, numri;
- të dhëna teknike të pajisjes për identifikimin dhe vlerësimin e zhurmave nga këto pajisje dhe nëse është e nevojshme, përshkrim skematik apo narrativ të këtyre karakteristikave;
- referencat ndaj direktivës përkatëse;
- një raport teknik mbi mënyrën e vlerësimit të zhurmave, në përputhje me kushtet e parashikuara në direktivë;
- instrumentet teknike të përdorura për matjen e zhurmës dhe rezultatet e marra.

Këto janë të dhëna minimale që duhet të shoqërojë çdo pajisje, e cila është përfshirë në këtë listë.

LISTA E PAJISJEVE TË PËRFSHIRA NË DIREKTIVËN E BE-SË PËR ZHURMAT

Tabela nr.16

Nr.	Emri i pajisjeve ose makinerive	
	Anglisht	Shqip
1.	Aerial access platforms with combustion engines	Vinç me platformë ajrore me motor diezel
2.	Brush cutter	Frezë, prerëse bari
3.	Builders' hoist for the transport of goods	Makinë betoniere, vinç për ngritje peshash dhe objektesh në ndërtim
4.	Building site band saw machine	Makina sharrimi me shirit
5.	Building site circular saw bench	Makinë sharrimi me disk
6.	Chain saw, portable	Platformë me zinxhirë lëvizës, motorsharrë
7.	Combined high pressure flusher and suction vehicle	Makinë e kombinuar thithëse dhe ventilimi me presion të lartë, bot transportimi nën presion
8.	Compaction machine	Makinë ngjeshëse, presimi metalesh etj.
9.	Compressor	Kompresor
10.	Concrete-breakers and picks	Thyese betoni, matrapik, çekiç pneumatik
11.	Concrete or mortar mixer	Përzierës betoni ose llaçi
12.	Construction winch	Vinç ndërtimi, çikrik kavosh
13.	Conveying and spraying machine for concrete and mortar	Makinë sprucimi, transportuese dhe shpërndarëse për beton dhe llaç
14.	Conveyorbelt	Rrip transportues
15.	Cooling equipment on vehicles	Pajisje ftohëse në makina, kondicioner, ventilator etj.
16.	Dozer	Buldozer
17.	Drill rig	Sondë shpimi, makinë shpimi për pilotë, betonime etj.
18.	Dumper	Makina të transportit të peshave shumë të rënda
19.	Dumper	Pajisje për ngarkim e shkarkim të rezervuarëve, tankeve, kamionëve
20.	Excavator, hydraulic or rope-operated	Ekskavator, hidraulik ose me kavo për hapjen e kanaleve ose të gërmimeve në tokë
21.	Excavator-loader	Ekskavator ngarkues
22.	Glass recycling container	Kontenier riciklues xhami
23.	Grader	Makinë niveluese
24.	Grass trimmer/grass edge trimmer	Makinë prerëse bari
25.	Hedge trimmer	Makinë krasitëse ose prerëse (drurëve ose bimëve dekorative

26.	High pressure flusher	Kompresor pastrues me ujë me presion
27.	High pressure water jet machine	Makina ose pompa të presionit të lartë
28.	Hydraulic hammer	Çekiç hidraulik
29.	Hydraulic power pack	Makinë presuese hidraulike
30.	Joint cutter	Sharrë prerëse (betoni, asfalti etj.)
31.	Landfill compactor, loader-type with bucket	Makinë ngjeshëse (rul për shtrimin e asfalteve, traseve të rrugëve etj.)
32.	Lawnmower	Makinë kositëse bari (për kositjen e tapeteve të barit , fushave sportive etj.)
33.	Lawn trimmer/lawn edge trimmer	Makinë prerëse bari/ makinë mbledhëse bari
34.	Leaf blower	Makinë kompresor për gjethet e pemëve
35.	Leaf collector	Makinë grumbullimi gjethesh
36.	Lift truck, combustion-engine driven, counterbalanced	Vinç për ngritjen e sendeve në lartësi dhe për ngarkim shkarkim (vinç me pirun)
37.	Loader	Ekskavator, buldozer për gjermim dhe ngarkim
38.	Mobile crane	Vinç i lëvizshëm
39.	Mobile waste container	Kontenier mbetjesh i lëvizshëm
40.	Motorhoe	Makinë shkrifëruese, punimi, gjermimi, kultivimi, frezë
41.	Paver-finisher	Makinë shtrim dhe nivelim asfalti, betoni etj.
42.	Piling equipment	Platformë për shpim dhe nguljen e shtyllave ose pilotëve
43.	Pipelayer	Vinç me zinxhir për ngritjen, transportimin dhe shtrimin e tubacioneve
44.	Piste caterpillar	Traktor me zinxhir
45.	Power generator	Gjenerator elektrik
46.	Powersweeper	Makina për pastrimin, smerilimin e rrugëve, asfaltit, betonit
47.	Refuse collection vehicle	Makinë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane
48.	Road-milling machine	Makinë për prishjen dhe bluarjen e asfaltit të rrugëve
49.	Scarifier	Makinë shpërndarëse, përzierëse bari
50.	Shredder/chipper	Makinë copëzuese e mbetjeve të drurit, bimëve, barit etj.
51.	Snow-removing machine with rotating tools	Makinë për largimin e borës me mjete rrotulluese (borëpastruese)
52.	Suction vehicle	Autobot, pompa uji për zjarrfikëset etj.
53.	Tower crane	Vinç kulle
54.	Trencher	Makinë për hapjen e kanaleve, gjermim të karierave shkëmbore etj.
55.	Truck mixer	Betoniere
56.	Waterpump unit	Motopompë me motor diesel e lëvizshme

Analiza e kuadrit ligjor për pajisjet dhe makineritë që shkaktojnë zhurma në mjedis

Nga analiza e kuadrit ligjor rregullator, që lidhet me konformitetin, shihet se nuk ka kërkesa specifike për pajisjet që gjenerojnë zhurmë. Ky kuadër ligjor rregullator përmban:

- ligjin nr.9779, datë 17.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”;

- vendimin nr.723, datë 5.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”.

Kërkesa specifike për konformitetin legjislacioni shqiptar parashikon për materialet e ndërtimit, si dhe për pajisjet nën presion. Sa u takon kërkesave specifike lidhur me konformitetin dhe veçanërisht me nivelin e zhurmave të gjeneruara nga pajisjet dhe mjetet e sektorit të ndërtimit, METE ka filluar dhe ka draftuar një rregullore për rregullat teknike të konformitetit, e cila është në proces shqyrtimi dhe miratimi, por që ende nuk është miratuar.

Nisur nga këto rrethana dhe nga kjo situatë, është e nevojshme që:

- ministria përkatëse për tregtinë duhet të përcaktojë kërkesat minimale që duhet të përmbushin pajisjet e listuara në direktivë dhe që gjenerojnë zhurmë;

- krijimin e strukturave për monitorimin e nivelit të zhurmave të gjeneruara nga këto pajisje;

- kontrollin e zbatimit të kërkesave ligjore nga përdoruesit e këtyre mjeteve për të përdorur mënyra dhe metoda për minimizimin e nivelit të zhurmave nga këto pajisje.

MASA TË DOMOSDOSHME PËR T'U NDËRMARRË NË TË ARDHMEN

Tabela nr.17

Nr.	Masat që duhen ndërmarrë	Institucioni përgjegjës	Afati (viti)
1.	Përmirësimet ligjore (ligjin për konformitetin dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat për organizimin dhe funksionimin e autorizuar për kryerjen e procedurave të konformitetit) për të përfshirë në legjislacionin aktual kërkesat për nivelin e lejuar të zhurmave nga pajisjet dhe certifikatën e konformitetit.	METE, MMPAU	2011
2.	Parashikimi i masave teknike dhe organizative për pajisjen me certifikatën specifike për zhurmat të pajisjeve të listuara në direktivën europiane për zhurmat dhe që prodhohen apo importohen në RSH.	METE, MPPT, MMPAU	2011
3.	Vlerësimi i numrit të popullsisë të ekspozuar nga zhurmat e gjeneruara nga këto pajisje dhe masat përkatëse për reduktimin e tyre.	METE, MB, MSH, MMPAU	2011
4.	Vlerësimi dhe hartimi i një inventari kombëtar (data- base) mbi numrin e pajisjeve dhe makinerive që shkaktojnë zhurma në mjedis dhe abdetimi i tij i përhershëm.	METE, MPPT	2012 e në vazhdim

Kërkesa të direktivës europiane për nivelin e zhurmave nga pajisjet dhe makineritë

Pajisjet e përfshira në këtë grup sipas direktivës përkatëse të BE-së (EU directive of 2000/14/EC of the European Parliament and the Council, of the 8 May 2000, on the approximation of the law of member state relating thew noise emmission in the environment by equipement for use outdoors), duhet të përmbushin një sërë kriteresh, si më poshtë:

- Të jenë të pajisura me certifikatën përkatëse, që vërteton nivelin e emetuar të zhurmave në mjedis;
- Të pajisen me certifikatën e konformitetit, që tregon se pajisjet janë prodhuar në përputhje me direktivën përkatëse të BE-së;
- Vendet anëtare të marrin masat për ngritjen dhe funksionimin e strukturave për verifikimin dhe pajisjen me certifikatën e konformitetit;
- Vendosja e kushteve të tregimit të këtyre pajisjeve në tregun e brendshëm sa u takon niveleve të lejuara të zhurmës nga këto pajisje;
- Ngritja e komitetit të vlerësimit të deklaratës së konformitetit të pajisjeve që gjenerojnë zhurmë në mjedis;
- Monitorimin dhe raportimin periodik i të dhënave lidhur me emetimin e zhurmave nga pajisjet objekt i kësaj direktive.

KAPITULLI IV
KOSTOJA FINANCIARE PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË ADMINISTRIMIT
MJEDISOR TË ZHURMAVE NË MJEDIS

Tabela nr.18

Nr.	Aktiviteti	Kostoja e përbushjes së aktivitetit	Institucioni përgjegjës për planifikimin e fondeve
1.	Përafrimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor me kërkesat e direktivës europiane për zhurmat	Kjo kosto mbulohet nga fondet e planifikuara në buxhetet e ministrive përkatëse	MMPAU, MPPT, MSH, METE, MB, MF
2.	Përgatitja e hartës kombëtare të zhurmave	20 milionë lekë	MMPAU
3.	Studimi dhe vlerësimi i gjendjes së sinjalistikës rrugore dhe hekurudhore për zhurmat dhe propozimi i masave konkrete për ndërhyrje	5 milionë lekë	MPPT
4.	Vlerësimi i zonave me kërkesa strikte ndaj zhurmave (spitale, shkolla, azile, kopshte, çerdhe etj.), dhe propozimi i masave përkatëse për minimizimin e zhurmave	10 milionë lekë	MSH, MASH, MPPT
5.	Investimet në akset ekzistuese të rrugëve dhe hekurudhave, me qëllim të kontrollit të nivelit të zhurmave nga sektori i transportit	Do të përcaktohen mbi bazën e kostove të përcaktuara në studimet përkatëse	MPPT
6.	Hartimi i planeve lokale të zhurmave në mjedis	12 plane për 12 qarqe Mesatarisht 3 milionë lekë për çdo plan = 36 milionë lekë	Qarqet
7.	Ngritja dhe funksionimi i sistemit të monitorimit të zhurmave në mjedis	10 milionë lekë	AKM
8.	Shuma e pjesshme (pa investimet)	81 milionë lekë	MMPAU, MPPT, MSH, METE, MB, MF

KAPITULLI V

Konkluzione

Kuadri ligjor rregullator dhe institucional për administrimin mjedisor dhe të qëndrueshëm të zhurmave në mjedis nuk është i plotë. Problematika e tij ka të bëjë me:

1. Boshllëqe në ekzistencën e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për zhurmat;
2. Mungojnë strukturat e certifikimit të nivelit të zhurmave në mjedis;
3. Shkalla e përafrimit të kuadrit ligjor me direktivat e BE-së dhe përfshirjen në to të kërkesave specifike për zhurmat është ende i ulët;
4. Mungojnë vlerësimet konkrete të impaktit dhe problematikës me zhurmat në mjedis që kanë sektorët e transportit, industrisë, aktivitetet tregtare, pajisjet që gjenerojë zhurmë etj.;
5. Mungojnë analiza dhe studime mbi masat konkrete që duhen ndërmarrë me qëllim të reduktimit të impaktit të zhurmave në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve;
6. Ka mungesa të sinjalistikës në sektorin e transportit lidhur me sinjalet specifike për zhurmat në mjedis;
7. Pajisjet që gjenerojnë zhurmë nuk kontrollohen për certifikatën e konformitetit dhe nuk ka kërkesa specifike për këto pajisje;
8. Nuk ka një hartë kombëtare të zhurmave, veçanërisht harta në zonat urbane.

Rekomandime

1. Plotësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor me kërkesa specifike të parashikuara në legjislacionin aktual dhe në direktivat e BE-së për zhurmat.

2. Vlerësimi i situatës dhe problematikës në çdo sektorët që gjenerojnë zhurma në mjedis dhe kanë efekte negative në shëndetin e njerëzve.
3. Vendosja e sinjalistikës rrugore për sinjalet lidhur me zhurmat.
4. Përgatitja e hartës së zhurmave në nivel kombëtar dhe për çdo njësi vendore.
5. Ngritja e strukturës për certifikimin e nivelit të zhurmave.
6. Marrja e masave për reduktimin apo administrimin e qëndrueshëm të zhurmave nga sektori i transportit, njësitë e shërbimit social, pajisjet dhe makineritë që gjenerojnë zhurmë.
7. Ngritja e Këshillit Teknik të Zhurmave pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Zhurmave në Mjedis, e cila të ketë në përbërje specialistë të fushave.
8. Ngritjen e seksionit të zhurmave në Institutin e Shëndetit Publik, si qendër reference kombëtare për problemet teknike të vlerësimit akustik të zhurmave dhe të efekteve në shëndet.
9. Rritje e përkujdesit dhe masave ndaj transportit rrugor, duke sensibilizuar dhe mbështetur transportin urban dhe forma të tjera alternative miqësore me mjedisin.
10. Vlerësimi dhe marrja e masave konkrete ndaj aktiviteteve të shërbimit social.

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE DHE FIGURAVE

- Tabela 1: Rrugët në Shqipëri sipas kategorive të tyre;
- Tabela 2: Mjetet e transportit rrugor sipas rretheve dhe qarqeve;
- Tabela 3: Klasifikimi i mjeteve sipas funksionit të tyre;
- Tabela 4: Kontrolli teknik vjetor dhe periodik i mjeteve rrugore (3-5 tonë);
- Tabela 5: Masa të domosdoshme për t'u ndërmarrë në fushën e transportit rrugor;
- Tabela 6: Të dhëna mbi numrin e fluturimeve dhe pasagjerëve nga Aeroporti i Rinastit;
- Tabela 7: Të dhëna për sistemin e monitorimit në aeroportin “Nënë Tereza”;
- Tabela 8: Të dhëna për sistemin e monitorimit në aeroportin “Nënë Tereza”;
- Tabela 9: Masa të domosdoshme për t'u ndërmarrë në transportin ajror;
- Tabela 10: Lokomotivat dhe vagonët e udhëtarëve në Shqipëri;
- Tabela 11: Mjetet e transportit hekurudhor dhe vëllimi i transportit të tyre;
- Tabela 12: Plani i masave që duhet ndërmarrë në transportin hekurudhor;
- Tabela 13: Plani i masave në sektorin e aktiviteteve të shërbimeve sociale;
- Tabela 14: Numri i popullsisë sipas qarqeve dhe rretheve;
- Tabela 15: Gjeneratorë të importuar tri vitet e fundit, 2007-2009;
- Tabela 16: Lista e pajisjeve të përfshira në direktivën e BE-së për zhurmat;
- Tabela 17: Masa të domosdoshme për t'u ndërmarrë në të ardhmen;
- Tabela 18: Kostoja financiare e zbatimit të planit kombëtar të zhurmave;
- Grafiku 1: Numri i pasagjerëve të transportit hekurudhor sipas viteve;
- Figura 1: Sinjalistika ndërkombëtare për zhurmat;
- Figura 2: Pozicionet e monitorimit të aeroportit “Nënë Tereza”.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 26.3.2011
Doli nga shtypi më 28.3.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë